



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 106-paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 5 të Rregullës Zgjedhore nr. 06/2013 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 18.02.2021, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për Rinumërim të Fletëvotimeve

- I. Miratohet rekomandimi i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për rinumërimin e fletëvotimeve, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të datës 14.02.2021.
- II. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i specifikuar sipas vendvotimeve.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Duke u bazuar në rekomandimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të datës 18.02.2021, gjatë procedimit, hetimit dhe auditimit të materialit zgjedhor nga vendvotimet e bashkangjitura këtij vendimi, është konstatuar disa nga të gjeturat si vijon:

Gjatë procesit të pranimit të materialit të ndjeshëm një numër i vendvotimeve nuk kanë mundur të pranohen si të rregullta. QNR në bazë të procedurave, heton të gjitha vendvotimet e dërguara në karantinë dhe nga të gjeturat rezulton se në disa vendvotim formularët janë të pa nënshkruara nga Këshillat e Vendvotimeve janë të pa plotësuar apo ka pasur probleme me shirita mbyllës. Prandaj, rekomandohet që të gjitha vendvotimet në të cilat rezulton se formularët janë të pa nënshkruara nga ana e Këshillit të Vendvotimit, janë të pa plotësuar apo probleme me shirita, të rinumërohen (rinumërim i plotë). Andaj, KQZ-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 18.02.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Priština



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Qendra e Numërimit dhe Rezultateve



Raporti i rasteve nga karantina gjatë Pranimit të materialit të ndjeshëm në QNR

Prishtinë, më 18.02.2021

Nr.	ID e Komunës	Komuna	Vendvotimi	Përshkrimi i Rastit	Datë	Veprimet e ndërmarra nga Ekipi Hetues	Të gjeturat nga Ekipi Hetues	Rekomandimi	Kategoria	Rekomandimi
7	2	Gjakovë/Dakovica	0202x/06R	Mungon FPR	18.02.2021			Rekomandimi 3	FPR	Te rinumerohet vendvotimi
16	9	Fushe Kosove/Kosovo Polje	0901e/10R	Mungojne nenshkrimet ne FRK	18.02.2021			Rekomandimi 3	FRK	Te rinumerohet vendvotimi
27	16	Rahovec/Orahovac	1632a/02D	FPR dhe FRK te paplotesuara	18.02.2021			Rekomandimi 3	FPR, FRK	Te rinumerohet vendvotimi
35	18	Podujevë/Podujevo	1810e/01R	Mungon FPR (vetem FPR e K-Vote)	18.02.2021	Mungon FPR	Ekipi i hetimit nuk ka mundur të gjejë FPR	Rekomandimi 3	FPR	Te rinumerohet vendvotimi
36	18	Podujevë/Podujevo	1816e/01R	Mungon nenshkrimi i kryesuesit ne FPR dhe FRK	18.02.2021			Rekomandimi 3	FPR, FRK	Te rinumerohet vendvotimi
37	18	Podujevë/Podujevo	1810e/02D	Mungon FPR	18.02.2021			Rekomandimi 3	FPR	Te rinumerohet vendvotimi
61	20	Prizren/Prizren	2056a/01D	Shiritat në kuti të Votimit	18.02.2021	Hapja e kutise dhe kontrollimi i fletëvotimeve	Thesi nr2 dhe nr4 jane hapur. Subjekti politik AAK i ka pasur 11 vota, dhe PDK 99. Pas hetimit AAK 12 dhe PDK 98.	Rekomandimi 3	FPR	Te rinumerohet vendvotimi
64	20	Prizren/Prizren	2068a/01R	Mungojne nenshkrimet ne FRK	18.02.2021			Rekomandimi 3	FRK	Te rinumerohet vendvotimi
72	21	Skenderaj/Srbica	2108b/01R	FRK e paplotesuar	18.02.2021			Rekomandimi 3	FRK	Te rinumerohet vendvotimi
79	24	Suhareke/Suva Reka	2433a/01D	FRK e paplotesuar	18.02.2021			Rekomandimi 3	FRK	Te rinumerohet vendvotimi
84	25	Ferizaj/Urosevac	2501d/09R	Shiritat në kuti të Votimit	18.02.2021	Hapja e kutise dhe kontrollimi	Thesi nr2 dhe nr4 jane hapur. Subjekti politik LVV i ka pasur 272 vota, dhe PDK 68. Pas hetimit LVV 271 dhe PDK 69.	Rekomandimi 3	FPR	Te rinumerohet vendvotimi
91	27	Vushtrri/Vucitrn	2704b/14D	FRK e paplotesuar	18.02.2021			Rekomandimi 3	FRK	Te rinumerohet vendvotimi